



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

Proces-verbal

**Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile
Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile**

I mbajtur sot më datë 11.04.2017 në orën 11:00 në ambientet e EU Info Center Tiranë.

Të pranishëm konfirmohen anëtarët si më poshtë- përfaqësues të Shoqërisë Civile pranë Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile:

1. Z. Luan Ahmetaj;
2. Z. Ergys Gezka;
3. Z. Ali Coka;
4. Znj. Livia Hidri (përfaqësuese e znj. Zana Vokopola);
5. Znj. Artemisi Shehu;
6. Znj. Erisa Lame;
7. Znj. Mirela Koçi;
8. Z. Altin Hazizaj;
9. Znj. Afërdita Seiti;
10. Z. Vladimir Thanu;
11. Z. Bledi Dibra;

Nga ana e Sekretariatit Teknik, të pranishëm janë:

1. Znj. Yllka Demollari;
2. Z. Ferhat Aga;
3. Z. Erion Banushi dhe
4. Z. Andi Luga;

Përfaqësues nga Këshilli i Ministrave i pranishëm është z. Ergis Sefa.

Përfaqësues nga Delegacioni European është znj. Enkelejda Bregu Lopari.

Nisja e mbledhjes inicoi me fjalën e hapjes nga znj. Enkelejda Bregu Lopari e cila fillimisht prezantoi arsyet e realizimit të kësaj mbledhjeje dhe ftoi të pranishmit të prezantojnë problematikat e tyre, vështirësitë por edhe mënyrën e zgjidhjes në funksion të gjetjes dhe ofrimit të ndihmës nga ana e Delegacionit të cilët kanë shprehur interesim të veçantë.

Enkelejda Bregu Lopari u shpreh edhe për prezantimin e pjesëmarrësve në mënyrë që të orientohen me njëri-tjetrin gjatë diskutimeve.

Enkelejda Bregu Lopari gjithashtu u shpreh se nga ana e Delegacionit, do të organizohen sesione informuese me temë: Dialogu Politik dhe Financimi i organizatave të shoqërisë civile. Në këto momente që flasim, po përpilohet edhe strategjia në tërësi dhe të integruar ka edhe strategjinë për shoqërinë civile i cili përbëhet nga tre komponentë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

1. Drejtësia;
2. Zhvillimi i turizmit me fokus lokal;
3. Menaxhimi i ujit.

Znj. Enkelejda Bregu Lopari gjithashtu shpjegoi se programi për shoqërinë civile 2016- 2017 fokusohet në tre prioritete dhe më i rëndësishmi është Mjedisi Mundësues për të cilin, propozoi organizim të takimeve për çdo dy apo tre muaj.

Z. Hazizaj mori fjalën dhe u shpreh se përveç problematikës së zgjedhjes së zëvendëskryetarit por edhe të Kryetarit të Këshillit- me rastin e ndryshimit të Ministrisë, kërkohet edhe organizimi i takimeve të natyrës study tour për të përthithur eksperiencat më të mira nga vëndet fqinje por edhe më tej. Z. Hazizaj gjithashtu u shpreh se ka propozuar (dhe është rënë dakord) për krijimin e Komiteteve të veçanta me përbërje nga Këshilli përkatësisht për:

- a) Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile;
- b) Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe
- c) Ngritjen e kapaciteteve të Shoqërisë Civile.

Enkelejda Bregu Lopari pyeti se si e perceptojnë përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në ndërmarrjen e kësaj iniciative?

Z. Dibra mori fjalën dhe pasi falenderoi Enkelejda Bregu Lopari u shpreh se mendimi i tij ishte që të krijohen forume aktive për realizimin e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile me natyrë periodike.

Z. Banushi ndërhyri duke u shprehur se kërkohet të ketë një komunikim të drejtëpërdrejtë përmes krijimit të një ure lidhëse.

Z. Dibra u shpreh gjithashtu se përballja me pjesën e Këshillit- përfaqësues të Institucioneve Qeveritare, do të duhet të sanksionohet më qartë dhe kjo lind nevojën për bashkëpunim me këto përfaqësues.

Z. Ahmetaj mori fjalën dhe u shpreh se propozon të bëhemi pjesë e Bordeve përkatëse sipas fushave përfaqësuese të secilit anëtar.

Enkelejda Bregu Lopari mori fjalën dhe pyeti nëse pjesën e legjislacionit do të ndryshohej nga vetë anëtarët apo do të nevojiten ekspertë?

Z. Hazizaj u shpreh se është krijuar një grup punë për zgjidhjen e kontraditës që ekziston mes Ligjit për Ofrimin e Shërbimeve dhe Financimit të Ofrimit të Shërbimit.

Z. Gezka mori fjalën dhe u shpreh se nevojiten propozime konkrete me qëllim çuarjen para të kësaj iniciative dhe t'i konsiderojmë institucionet si përfaqësues.

Z. Thanu u shpreh se ende nuk është zgjedhur zëvendëskryetari pasi ka ngërç në këtë zgjedhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Z. Banushi u shpreh se ky ngërç ka ardhur si pasojë e mosrakordimit mes përfaqësuesve të shoqërisë civile pranë Këshillit pasi vullneti i mirë, ishte prezent në mbledhjen e parë të të gjithë Këshillit.

Z. Thano gjithashtu u shpreh mbi përcaktimin e mekanizmave që do të investohen për krijimin e komuniteteve dhe më tej, nevojitet krijimi i një strategjie në mënyrë që të finalizohet diçka nga ky Këshill.

Anëtarët e pranishëm u shprehën të gatshëm për të bashkëpunuar me zyrën e Delegacionit Europian për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm të nevojshëm.

z. Thano më tej vijoi fjalën e tij duke u shprehur se Këshilli duhet të dialogojë përmes një dialogu të strukturuar me: me shoqërinë civile, target- grupet dhe me institucionet publike.

Znj. Livia Hidri propozoi lidhur me zgjedhjen e zëvendëskryetarit që të votohej personi që ka marrë më shumë vota por anëtarët e tjerë u shprehën se kjo mënyrë shfaq heqjen e të drejtës për kandidim.

Znj. Koçi mori fjalën dhe u shpreh se propozonte zgjidhje të marrëveshjes mes Bashkimit Europian dhe Qeverisë Shqiptare me përfaqësues Ministrinë e Financave lidhur me rimbursimin e T.V.Sh.- së. Për këtë qëllim, është shpallur edhe një udhëzim i qartë i cili ende nuk po zbatohet. Znj. Koçi përmendi se është e njëjta procedurë e cila u ndoq edhe nga biznesi. Ekziston një numër i madh i organizatave jofitimprurëse me status pasiv si për nga financimi ashtu edhe për nga realizimi i aktiviteteve dhe kjo sjell nevojën për krijimin e një databaze përmbledhëse për organizatat e shoqërisë civile.

Z. Dibra mori fjalën dhe u shpreh se nevojitet mbledhja pranë selisë së Këshillit të Ministrave si sanksion i Ligjit për Këshillin dhe në këtë moment, ndërhyri z. Thano e z. Gezka të cilët interpretuan çështje të kësaj natyreje dhe u shprehën se kjo është një mbledhje joformale e Këshillit.

Fjalën e mori z. Coka i cili ngriti problemin e fushës së agronomisë duke propozuar krijimin e një fondi të veçantë për këtë sektor.

Znj. Seiti u shpreh mbi qartësimin e pozicionit të zyrës së Delegacionit- propozim i cili u miratua nga znj. Enkelejda Bregu Lopari.

Më tej u diskutua mbi financimin për veprimtarinë e Këshillit duke propozuar një shumë prej rreth 5.000.000 (pesë milionë) lekësh dhe z. Banushi u shpreh se ky financim do të aprovohet në momentin që do të rishikohet buxheti i Institucionit.

Znj. Enkelejda Bregu Lopari mori fjalën dhe u shpreh përmbyllurazi duke cituar se nevojitet kryesisht:

1. Plani Vjetor i Këshillit;
2. Propozimet e Këshillit dhe
3. Nevojat për ndryshimet ligjore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Të tre këto procese, do të lehtësonin edhe orientimin për mbështetje të zyrës së Delegacionit.

Z. Gezka u shpreh se realizimi i këtyre tre proceseve do të sjellë nevojën për dhënien e opinionit nga ana e Institucioneve Shtetërore.

Më tej, fjalën e mori z. Sefa ku u shpreh se vonesa në zgjedhjen e zëvendëskryetarit është si pasojë e mosrënies dakord të vetë anëtarëve të Këshillit- pjesë e përfaqësimit të shoqërisë civile. z. Sefa u shpreh se iniciativat e Këshillit do të jenë të mbështetura edhe nga Qeveria Shqiptare. Me këtë rast, z. Sefa, prezantoi edhe hapat e marra mbi programin specifik për shoqërinë civile dhe organizimin e trajnimeve për këtë sektor në përgjithësi por veçanërisht, për përfaqësinë e shoqërisë civile pranë Këshillit.

Mbledhja u mbyll në orën 13:40.